

**Naser FERRI**

Instituti Albanologjik-Prishtinë

Email: naserferri@yahoo.com

ORCID: <https://orcid.org/0009-0008-4112-871X>

KUD: 930.1(496.51)(05)

**GJETJE TË REJA TË MONEDHAVE ROMAKE NË VËRBAN TË KLLOKOTIT****Abstrakt:**

*Në lokalitetin arkeologjik në Vërban të Kllokotit, afër Vitisë së Kosovës vazhdimisht gjenden artefakte të periudhës romake dhe bizantine. Më herët në këtë lokalitet janë gjetur një varg reliktesh nga periudha romake, në mesin e të cilëve pa dyshim vend të veçantë zë busti prej mermeri i “Zonjes Dardane”, i cili paraqet një femër nga shtresat aristokrate dardane me veshje karakteristike ilire dhe me stoli karakteristike ekskluzivisht për gratë dardane. Gjatë pranverës dhe vjeshtës të viteve 2023 e 2024 gjatë punimeve bujqësore si zbulime rasti janë gjetur një numër i konsiderueshëm monedhash, që i përkasin periudhës të sundimit romak në Kosovë prej shekullit II<sup>o</sup> deri në gjysmën e dytë të shekullit VI<sup>o</sup> të erës sonë, respektivisht kohës së perandorëve Faustina Maior (bashkëshortja e perandorit Antoninus Pius, 138-140) e Sallustia Orbiana (bashkëshortja e perandorit Severus Alexander, 225-227) dhe të perandorëve: Septimius Severus (193-211), Geta (209-211), Gordianus III<sup>o</sup> (238-238-244), Philippus I<sup>o</sup> (244-249), Trebonianus Gallus (251-253), Volusianus (251-253), Gallienus (253-268), Aurelianus (270-275), Diocletianus (284-305), Constantinus I<sup>o</sup> (306-337), Constantius Gallus (326-354), Constantius II<sup>o</sup> (337-361), Valentinianus I<sup>o</sup> (364-375), Valens (364-378) dhe të perandorit bizantin Justinianus I<sup>o</sup> (527-565). Në averse të këtyre monedhave janë paraqitjet e portreteve të perandorëve të përmendur, ndërsa në reversë paraqitën figurat e perandorëve por edhe të hyjnive: Sol (hyj i Diellit), Annona (hyjneshë e lidhur me hyjneshën Ceres, dhe personifikim hyjnor i shpërndarjes së drithit popullit romak), Ceres (Cerera, hyjneshë kjo e bujqësisë dhe e pjellorisë), Securitas (hyjneshë e sigurisë së shtetit), Concordia (hyjneshë e harmonisë), Roma (hyjneshë e cila e personifikonte qytetin e Romës) e Victoria (hyjneshë me flatra e fitores, më së shpeshti e*

*paraqitur në reverse të monedhave romake), paraqitjet e kafshëve të ndryshme ose shkronjat e mëdha që tregojnë vlerën nominale të monedhës si në rastin e follisit të kohës së perandorit Justiniani I<sup>o</sup>. Monedhat janë të punuara prej argjendi e prej bronzi dhe i përkasin llojeve të ndryshme. Në mesin e tyre ka monedha të llojit: denarius, sestertius, antoninianus, antoninianus të reformuar me rastin e reformave të perandorit Caracalla (198-217), pastaj monedha prej bronzi të llojit nummus, follis, follis i reduktuar e poashtu edhe solidus i reformuar me rastin e reformave të perandorit Constantinus Maximus (Kostandini i Madh, 306-337), imitime prej bronzi të monedhave prej argjendi si dhe monedhat përkujtimore dhe monedha e ashtuquajtur „limes denarius“ që ishte imitim i denariusit të argjeditë zyrtar, e punuar për paga të njësiteve ushtarake të stacionuara në provincat danubiane. Në bazë të te dhënave nga mbishkrimet që janë në ekserge (segmente) të këtyre monedhave kuptohet se ato ishin prerë në punëtoritë qendrore monedhëprerëse të Romës, por edhe nëpër punëtori monehdëprerëse provinciale: në Viminacium (Mezi e Epërme, Kostollac i sotëm në Serbi), Romë (Itali), Ticinum (Pavia, Itali), Lugdunum (Lion, Francë), Antiochia, Constantinopolis (Turqi), Thessalonica (Greqi).*

**Fjalë kyçe:** Kosovë, Vërban i Kllokotit, monedhat romake, monedhat bizantine, perandorët romakë, hyjnitë romake.

### **Abstract:**

*At the archaeological site in Vërban of Kllokot, near Viti in Kosovo, artifacts from the Roman and Byzantine periods are continuously being discovered. Earlier, a series of relics from the Roman period were found at this site, among which a particularly notable place is held by the marble bust of the “Dardanian Lady,” depicting a woman from the Dardanian aristocratic class, dressed in characteristic Illyrian attire and adorned with ornaments exclusive to Dardanian women. During the spring and autumn of 2023 and 2024, a considerable number of coins were discovered as chance finds during agricultural work, belonging to the period of Roman rule in Kosovo from the 2nd century to the second half of the 6th century AD. These coins correspond to the times of the empresses Faustina Maior (wife of Emperor Antoninus Pius, 138-140) and Sallustia Orbiana (wife of Emperor Severus Alexander, 225-227), as well as to the emperors: Septimius Severus (193-211), Geta (209-211), Gordian III (238-244), Philip I (244-249), Trebonianus Gallus (251-253), Volusianus (251-253), Gallienus (253-268), Aurelian (270-275),*

*Diocletian (284-305), Constantine I (306-337), Constantius Gallus (326-354), Constantius II (337-361), Valentinian I (364-375), Valens (364-378), and the Byzantine emperor Justinian I (527-565). On the obverse of these coins are depictions of the aforementioned emperors, while the reverse features images of the emperors as well as deities: Sol (the Sun god), Annona (a goddess associated with Ceres, representing the divine personification of grain distribution to the Roman people), Ceres (goddess of agriculture and fertility), Securitas (goddess of state security), Concordia (goddess of harmony), Roma (goddess personifying the city of Rome), and Victoria (winged goddess of victory, most commonly depicted on the reverse of Roman coins), along with representations of various animals or large letters indicating the coin's nominal value, as in the case of the follis from the time of Emperor Justinian I. The coins are made of silver and bronze and belong to different types. Among them are coins of the types: denarius, sestertius, antoninianus, the reformed antoninianus introduced during the reforms of Emperor Caracalla (198-217); then bronze coins of the types nummus, follis, reduced follis, as well as the reformed solidus introduced during the reforms of Emperor Constantine the Great (306-337); bronze imitations of silver coins; commemorative coins; and the so-called "limes denarius," which was an imitation of the official silver denarius, minted to pay military units stationed in the Danubian provinces. Based on the data from the inscriptions on the exergues (segments) of these coins, it is understood that they were minted in the central mints of Rome, as well as in provincial mints: in Viminacium (Upper Mezi, present-day Kostolac in Serbia), Rome (Italy), Ticinum (Pavia, Italy), Lugdunum (Lyon, France), Antioch, Constantinople (Turkey), and Thessalonica (Greece).*

**Keywords:** Kosovo, Vërban of Kllokot, Roman coins, Byzantine coins, Roman emperors, Roman deities.

Shkenca e numizmatikës (nga nomisma: gr.-monedhë) është shkencë mbi krijimin, zhvillimin dhe përdorimin e monedhave dhe objekteve simotra prej metali siç janë medaljonet, kontorniatët e të ngjashme. Numizmatika i trajton monedhat si burim relevant për studime në fushën e historisë, para së gjithash të asaj ekonomike e politike, por edhe të historisë sociale, të religjioneve, të historisë së arteve etj.<sup>1</sup> Trajtat, materiali prej të cilit janë punuar monedhat

<sup>1</sup> Suarez 2005: II.

si dhe mbishkrimet mbi faqe (avers) e shpinë (revers) të monedhave të cilat hyjnë në kategorinë e epigrafisë monetare,<sup>2</sup> së bashku me elementet e tjera përcjellëse, janë ndihmesë e madhe për studime arkeologjike, posaçërisht kur është fjala për datimin e materialit arkeologjik së bashku me të cilin janë gjetur monedhat. Lokaliteti Vërban afër Kllokotit, i vendosur në rrafshinën aluviale të pasur me burime të ujit termomineral është një ndër vendbanimet e mëdha antike në Kosovë i njohur tash e shumë kohë si lokalitet i pasur me relikte të ndryshme të periudhës romake. Pos relikteve arkitektonike aty më herët janë gjetur artefakte të vlefshme siç është bie fjala busti i njohur si “*Dardanja*” me veshje e stoli karakteristike për gratë dardane, ndërsa aty vazhdimisht gjenden monedha të periudhave të sundimit të perandorëve të ndryshëm romak.<sup>3</sup> Gjatë vitit 2023 dhe 2024 si zbulime rasti janë gjetur një numër i konsiderueshëm sosh, prej argjendi e prej bronzi të prodhuara nëpër punëtoritë monedhëprerëse të Romës, Kostandinopojës dhe të qendrave të ndryshme provinciale, të cilat qarkullonin në këtë rajon gjatë kohës së sundimit romak, nga të cilët një pjesë trajtohen me këtë rast në mënyrë shkencore.



“Dardanja” - Bust mermeri i gjetur në Vërban të Kllokotit, shek. II  
(Foto: Koleksion arkeologjik i Muzeut të Kosovës)

Koleksioni numizmatik i gjetur në Vërban të Kllokotit përfshinë këto monedha: **1.** Denar (denarius, prej argjendi me vlerë prej 10 asë deri në shekullin III<sup>o</sup> të erës sonë, e më vonë është zëvendësuar me antoninianus poashtu prej argjendi)<sup>4</sup> me madhësi prej 19 mm dhe me peshë prej 2,87 gr.

<sup>2</sup> Calabi Limentani 1985: 325.

<sup>3</sup> Čerškov 1969: 33-34.

<sup>4</sup> Klawans 1959: 12; Room 1987: 62.

Në avers të kësaj monedhe është paraqitjet e portretit të djathtë i perandoreshës Faustina dhe rreth tij mbishkrimi: Diva Faustina.<sup>5</sup>



Denar prej argjendi i kohës së perandoreshës  
Faustina Maior (Faustina e Vjetër)

Në revers është paraqitja e figurës së hyjneshës Cerera me kallinj gruri në dorë të djathtë dhe me pishtar në dorën e majtë.

Monedha është e kohës së perandoreshës Faustina e Vjetër (Annia Galeria Faustina, Faustina Major, 100-140),<sup>6</sup> bashkëshortës së perandorit Antonin Piu (Imp. Caesar T. Aelius Hadrianus Antoninus Aug Pius, 138-167).<sup>7</sup> Në kohën e Perandorisë Romake pjesëtarët e familjes së ngushtë perandorake (nënat, bashkëshortet, motrat, vajzat) kishin të drejtë të prenin monedha në të cilat paraqitëshin portretet e tyre me frizura dhe me cilësi të tjera karakteristike ikonografike dhe me emra dhe me tituj të pjesëtareve të familjes perandorake (DIVA, DIVA AVGVSTA, AVGVSTA). Monedha është prerë në Romë, ndërsa sipas cilësive që i ka, është prerë në vitin 141 të erës sonë.<sup>8</sup>

2. Sesterc (sestertius, monedhë prej bronzi me vlerë prej 2 asë e gjysëm)<sup>9</sup> i perandorit Septimius Severus (Imp Caesar Lucius Septimius Severus Pertinax Augustus, 193-211)<sup>10</sup> me diameter prej 29 mm dhe me peshë prej 18 gr. Në avers është paraqitja e portretit të të djathtë të perandorit Septimius Severus me kurorë në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: L SEPT SEV PERT AVG IMP III (Lucius Septimius Severus Pertinax Augustus Imperator III (tertium)).

<sup>5</sup> Sear 1988: 161-162.

<sup>6</sup> Cagnat 1914: 199; Hafner 2001: 117-118.

<sup>7</sup> Cagnat 1914: 197-199. Veh 2001: 10-11; Hafner 2201: 46-47.

<sup>8</sup> RIC III 382A.

<sup>9</sup> Cagnat 1914: 206-208; Klawans 1959: 12; Room 1987: 193.

<sup>10</sup> Cagnat 1014: 206-208; Hafner 2001: 250-151; Veh 2001: 98-100.



Sesterce prej bronzi i kohës së perandorit Septimius Severus

Në revers është paraqitja e figures së hyjneshës romake Annona në këmbë e kthyer djathtas, e cila në dorën e djathtë mbanë kaduceun ndërsa në të majtën mbanë bririn e bollëkut.

Annona ishte perëndeshë romake e rangut të ulët e grurit, drithërave dhe e bereqeteve në përgjithësi, të cilën romakët e konsideronin si shërbëtore të hyjneshës së lashtë italice të vegjetacionit e bujqësisë Ceres apo Cerera).<sup>11</sup> Në të dy anët e këmbëve të hyjneshës janë shkronjat SC (Senatus Consultum monedha është prerë me lejen e Senatit Romak) e rreth figures së hyjneshes është mbishkrimi: ANNONA AVG COS II PP (Annona Augusta Consul II (iterum) Pater Patriae. Në bazë të shënimeve në mbishkrim monedha është e prerë në Romë, në vitin 194 të erës sonë.<sup>12</sup> Në bazë të shënimeve në revers të monedhës kuptohet që ajo ishte prerë mes viteve 196-196<sup>13</sup> në punëtoritë monedhaprerëse të Romës.

**3.** Denar i argjendtë i perandorit Geta (Imp Caesar Publius Septimius Geta, 209-211)<sup>14</sup> nga koha derisa ishte princ, para se të behet perandor. Monedha në fjalë ka diametrin prej 20 mm dhe peshën prej 3,17 gr.

<sup>11</sup> Dizionario illustrato 2012: 120; Schmidt 2004: 84; Spaeth 1996; Srejović, Cer-manović-Kuzmanović 1979: 494-495.

<sup>12</sup> RIC IV, 677.

<sup>13</sup> Cagnat 1914: 207.

<sup>14</sup> Cagnat 1914: 211; Čerškov 1969: 57; Matijašić 2002: 234-235; Hafner 2001: 125.



Denar prej argjendi i kohës së perandorit Geta

Në avers është paraqitja e portretit e princit Geta dhe rreth tij mbishkrimi: P SEPT GETA CAES PONT (Publius Septimius Geta Caesar Pontifex).

Në revers është paraqitur një figurë në kembe dhe rreth saj mbishkrimi: PRINC IVVENTVTIS Princeps iuventutis- i pari nga të rinjtë) titull i trashëguesve të perandorit, të cilin për herë të parë e kishin përdorur Gaius dhe Lucius, nipërit e perandorit të parë romak Augustus (Caius Julius Caesar Octavianus).<sup>15</sup> Monedha është prerë në Romë mes viteve 209-211 të erës sonë.

4. Denar i argjendtë i kohës së perandoreshës Sallustia Orbiana Augusta (Cnaea Seia Herennia Salustia Barbia Orbiana 225-227, bashkëshortja e perandorit Severus Alexander)<sup>16</sup> me diametër prej 19 mm dhe peshë prej 2,90 gr. Në avers është portreti i perandoreshës me diademë në kokë dhe rreth portretit mbishkrimi: SALL BARBIA ORBIANA AVG (Sallustia Barbia Orbiana Augusta). Në revers është paraqitja e figurës së hyjneshës Concordia të ulur mbi fron me kurorë në kokë, e cila në dorën e djathtë mbanë paterën (lloj ene) ndërsa në të djathtën bririn e dyfishtë të bollëkut dhe rreth figurës mbishkrimi: CONCORDIA AVGVSTORVM SC (Concordia Augustorum, Senatus Consulto).

<sup>15</sup> Cagnat 1914: 180.

<sup>16</sup> Cagnat 1914: 213-214; Hafner 2001: 251-252.



Denar prej argjendi i kohës së perandoreshës Sallustia Orbiana

Monedha është prerë në Romë mes viteve 225 e 227<sup>17</sup> dhe për shkak të cilësive të veta është raritet numizmatik.

5. Sesterce (sestertius) i periudhës së sundimit të perandorit Gordianus III° (Imp Caesar Marcus Antonius Gordianus Augustus, 238-244).<sup>18</sup> Monedha është prej bronzi me një diametër prej 20 mm dhe peshë prej 7,32 gr.



Sesterce prej bronzi i kohës së perandorit Gordianus III°

Në avers të monedhës është paraqitur portreti i djathtë i perandorit me një kurorë në formën e rrezeve të diellit në kokë, rreth së cilës është mbishkrimi: IMP GORDIANVS PIVS FEL AVG (Imperator Gordianus Pius Felix Augustus), ndërsa në revers është paraqitur figura në këmbë e hyjneshes Victoria, e cila personifikon provincën Moesia Superior dhe nga të dy anët e saja janë paraqitjet e figurave të luanit në të majtë dhe ajo e demit në anën e djathtë që simbolizojnë Legio VII° Claudia (demi) dhe të Legio IV° Flavia (luani), të cilat ishin të vendosura në Mezi të Epëme.

<sup>17</sup> RIC IVb 319; Cohen 1930:5.

<sup>18</sup> Cagnat 1914: 215-216; Veh 2001: 41; Hafner 2001: 126-127.

Në anën e sipërme sipër figurës është mbshkrimi: PMS COL VIM (Provinciae Moesiae Superioris Colonia Viminacium), ndërsa poshtë këtyre figurave shënimi për datën e prerjes së monedhës: AN IIII (anno quarto). Monedhat me paraqitje të simboleve ushtarake janë mjaft të rralla në Kosovë meqë më herët janë gjetur vetëm edhe në rajonin e Pejës,<sup>19</sup> në Tupec të Prizrenit<sup>20</sup> dhe në lokalitetin Izvore afër Mitrovicës.<sup>21</sup> Në bazë të shënimit AN IIII (anno quarto) monedha është prerë në vitin e katërt nga fillimi i veprimtarisë së monetares monetare Viminacium, përkatësisht në vitin 242/243 të erës sonë.

6. Sesterc prej bronzi kohës së perandorit Philippus I° (Filipi Arab), i ruajtur mjaft mirë, me përmasa 28-29 mm dhe peshë 18 gram. Në avers të monedhës është paraqitur portreti djathtas i perandorit me një kurorë dafine në kokë dhe rreth këtij portreti është mbshkrimi: IMP M IVL PHILLIPVS AVG (Imperator Marcus Julius Philippus Augustus)<sup>22</sup> që do të thotë që monedha është e e periudhës së sundimit të perandorit Filipi Arab (Imp. Caesar M. Julius Philippus Aug).<sup>23</sup>

Në revers të monedhës është paraqitja e figurës së hyjneshës Victoria (e cila personifikon provincën Moesia Superior) në këmbë, me kokë të zbuluar, e veshur me tunikë të gjatë me duar të zgjatura mbi dy kafshët anash saj: demin, në anën e djathtë dhe luanin në anën e majtë, të dyja të paraqitura në lëvizje. Këto dy kafshë simbolizojnë legjionet të cilët përbënin ekuipazhin ushtarak të Mezisë së Epërme: demi simbolizonte Legio VII° Claudia ndërsa luani Legio IV° Flavia.<sup>24</sup> Që të dyja këto legjionet e përmendura ishin të stacionuara në Mezi, respektivisht në Mezi të Epërme prej gjysmës së shekullit I° e deri në fund të antikës me kampe të përhershme ushtarake në Viminacium (Legio VII° Claudia) dhe Singidunum (Legio IV° Flavia), ndërsa disa nga repartet e tyre ishin të stacionuara edhe në territorin e Kosovës së sotme (Kaçanik, Smirë, Ulpianë, Vushtrri, Mitrovicë, Soçanicë, Istog, Gjakovë, Prizren).<sup>25</sup> Në pjesën e epërme të reversit të monedhës, sipër figurave të përmendura është mbshkrimi i shkruar me shkurtesa: PMS COL VIM (Provinciae Moesiae

<sup>19</sup> Ferri 2019: 289-325; Ferri 2021: 41-60; Ferri 2023: 267-279.

<sup>20</sup> Ferri 2023: 284.

<sup>21</sup> Stamenković, Samardžić 2013: 168-181; Ferri 2023: 280-283.

<sup>22</sup> Varbanov 2005, 135; Ferri 2008b: 31; Ferri 2019: 314-318.

<sup>23</sup> Cagnat 1914: 217-218; Veh 2001: 25; Hafner 2001: 126-127; Matijašić 2002: 235.

<sup>24</sup> Ferri 2001: 63, 66.

<sup>25</sup> Ferri 2001: 66-67, 182, 186, 189, 19157, 195, 196.

Superioris Colonia Viminacium) dhe në pjesën e poshtme nën figurat shënohet viti i prerjes së monedhës: AN VII (anno septimo-viti i shtatë) sipas erës lokale, duke llogaritur nga fillimi i veprimtarisë së punëtorisë monedhëprerëse e cila vepronte në Viminacium nga viti 239 të erës sonë.<sup>26</sup>

Mbishkrimi në anën e pasme tregon se monedha është prerë në punëtorinë monedhëprerëse në Viminacium, ndërsa viti i shënuar tregon datën e saktë të prerjes së saj, d.m.th. 245/246 të erës sonë. Punëtoria monedhëprerëse e Viminaciumit ka funksionuar nga tetori i vitit 239 të erës sonë derisa perandori Gallienus (253-268)<sup>27</sup> në vitin 255 të erës sonë i kishte mbyllur shumë punëtori monedhëprerëse nëpër provinca të Perandorisë, duke përfshirë edhe këtë në Viminacium.<sup>28</sup>



Sesterc prej bronzi i kohës së perandorit Philippus I° (Filipi Arab)

Në bazë të të dhënave nga mbishkrimi në reversin e monedhës, respektivisht të shënimit AN VII (anno septimo) që shenon vitin e shtatë nga fillimi i veprimtarisë së punëtorisë monedhëprerëse në Viminacium e cila kishte filluar së vepruari në vitin 239<sup>29</sup> të erës sonë shihet që monedha është prerë në Viminacium në vitin 246 të erës sonë. Pos kësaj monedhe të perandorit Filipi Arab të gjetur në Vërban, monedha të perandorit Filipi Arab më paraqitje të njëjta në avers e revers janë gjetur edhe dy sosh në rajon të Pejës,<sup>30</sup> 10 ekzemplarë në thesarin e gjetur në lokalitetin Izvore afër Mitrovicës<sup>31</sup> dhe në disa lokalitete të tjera.

<sup>26</sup> Bakos 1994: 368-376; Vojvoda, Redžić 2018: 51-52.

<sup>27</sup> Cagnat 1914: 222-223; Hafner 2001: 123-124.

<sup>28</sup> Borić-Brešković 1976: 8; Spasić-Đurić 2002: 152-153.

<sup>29</sup> Pick 1898: n.81.

<sup>30</sup> Ferri 2019: 314-318; Ferri 2023: 248-254; 267-274.

<sup>31</sup> Stamenković, Samardžić 2013: 171-173 n. 2-11.

7. Imitim prej bronzi i denarit të argjendtë me dimensione 22 mm dhe me peshë 3,50 gr. i kohës së perandorit Filipi Arab me dimensione 22 mm dhe me peshë 3,50 gr. Në avers potreti i djathtë i perandorit me kurorë në formë rrezesh në kokë e rreth tij mbishkrimi: IMP M IVL PHILIPPVS AVG. Në revers hyjnesha Felicitas në këmbë me kaducej në dorën e djathtë dhe bririn e bollëkut në të majtë. Rreth saj mbishkrimi: FELICITAS TEMP-kohët e lumtura ose prosperiteti i kohëve i cili pasqyron virtytet e reja që kishin filluar të shfaqen nga koha e perandorëve Trajan e Antonin Piu e vazhdojnë tutje. Kjo monedhë është imitim i denarit të argjend të punuar prej bronzi të veshur me një shtresë argjendi dhe hyn në kategorinë e “denareve të Limesit” respektivisht variantit të lire të denareve të argjendte të cilët janë emetuar për paga të ushtarëve të cilët kanë shërbyer në kufi në Danub.<sup>32</sup>



Imitim prej bronzi i denarit të argjendtë i kohës së perandorit Philippus Io (Filipi Arab)

Sipas gjasave monedhën në fjlë në Verban e ka sjelle ndonjë ushtar i Legio VII<sup>o</sup> Claudia ose Legio IV<sup>o</sup> Flavia i cili me heret ka shërbyer në kufi. Përndryshe repartet e Legio VII<sup>o</sup> Claudia e Legio IV<sup>o</sup> Flavia kanë qene të stacionuara në Dardani prej shekullit I<sup>o</sup> deri në fund të shekullit IV<sup>o</sup> të eres sone. Deri tash nuk është gjetur ndonjë denar i ketille në territorin e Kosovës.

8. Antoninian (antoninianus) prej bronzi i kohës së perandorit Gallienus ((Imp Caesar P Licinius Valerianus Egnatius Gallienus, 253-268),<sup>33</sup> me dimensione 21 mm dhe me peshë prej 3,12 gr.

<sup>32</sup> RIC 31.

<sup>33</sup> Cagnat 1914: 222-223.



Antoninianus prej bronzi i mbështjellur me argjend i kohës së perandorit Gallienus

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me kurorë në formë rrezesh në kokë dhe mbishkrimi: GALLIENVS AVG (Gallienus Augustus). Në revers është paraqitja e një antilope<sup>34</sup> të kthyer në anën e djathtë dhe rreth saj mbishkrimi: DIANAЕ CONS AVG (Dianae Conservatori Augusti-Dianës, mbrojtësës së perandorit).<sup>35</sup> Monedha i përket emisionit të monedhave me kafshë të perandorit Gallienus (Zoo Serie ose L'emmission du bestiere)<sup>36</sup> dhe është prerë në Romë mes viteve 267 dhe 268 të erës sonë.

9. Sesterc (sestertius) prej bronzi me diameter 27 mm dhe me peshë 11 gr. Për shkak të dëmtimit të mbishkrimit në avers nuk mund të caktohet në mënyrë të saktë në kohë të te cilit perandor është prerë, por meqë i bie viti 251/252 të erës sonë mund të jetë i kohës së perandorëve Trajanus Decius (249-251), Hostilianus (ka sunduar disa muaj gjatë vitit 251), Trebonianus Gallus dhe Volusianus të cilët kanë bashkësunduar mes viteve 251-253 të erës sonë.



Sesterc prej bronzi i kohës së perandorëve Trajanus Decius, Hostilianus, Trebonianus Gallus ose i perandorit Volusianus të cilët kanë bashkësunduar mes viteve 251-253 të erës sonë.

<sup>34</sup> RIC V-1 283; Sear 1988: 10362.

<sup>35</sup> Cohen 157,158,160; RIC V, 179, 180, 181.

<sup>36</sup> Wolkow 2019: 26a.

Në bazë të analogjive të portretit të paraqitur në avers monedha është prerë në kohën e perandorit Trebonianus Gallus (Imp Caesar Caius Vibius Trebonianus Gallus Augustus, 251-253),<sup>37</sup> në punëtorinë monedhaprerëse të Viminaciumit në vitin XIII<sup>o</sup> të erës lokale (251-252).<sup>38</sup> Meqë mbishkrimi në avers është i palexueshëm, në bazë të analogjive me monedhat tjera, rreth portretit të perandorit duhet të ketë qenë mbishkrimi: IMP C VIBIO TREBON GALLO AVG (Imperatori Caio Vibio Treboniano Gallo Augusto).

Në revers është paraqitja e hyjneshes romake Victoria e cila personifikon provincën Moesia Superior me simbole te Legio VII<sup>o</sup> Claudia (demi) dhe Legio IV<sup>o</sup> Flavia (luani) nga dy anët e saja. Rreth figurave mbishkrimi: PMS COL VIM (Provinciae Moesiae Superioris Colonia Viminacium, dhe nën këto figura shenja: AN XIII (anno tertio decimo-viti i trembëdhjetë). Sipas këtyre të dhënave monedha është prerë në Viminacium në vitin 13 të erës lokale nga fillimi i veprimtarisë monedhëprerëse, pra në vitin 251/252 të erës sonë. Një sesterc me tipare të njëjta i perandorit Volusianus është gjetur në vitin 2004 në thesarin e monedhave të gjetura në lokalitetin Izvore afër Mitrovicës, i prerë poashtu në vitin XIII<sup>o</sup> të erës lokale të Viminaciumit (251/252),<sup>39</sup> dhe një tjetër monedhë e Volusianit është gjetur rreth vitit 1983 në Tupec të Prizrenit, me tipare të njëjta por me dallim që kjo monedhë në revers rreth figurave të hyjneshës Victoria, të demit e luanit ka mbishkrimin PROVINCIA DACIA dhe datimin: AN V (anno quinto-viti i pestë).<sup>40</sup> Kjo monedhë e gjetur në Tupec ishte prerë në Viminacium në vitin 244.<sup>41</sup>

**10.** Antoninian (antoninianus) prej bronzi i mbështjellur me argjend, me vlerë të denarit të dyfishtë, i futur në qarkullim në vitin 215, respektivisht në kohën e perandorit Marcus Aurelius (Mark Aureli), i cili gradualisht e kishte zëvendësuar denarin)<sup>42</sup> i kohës së sundimit të perandorit Aurelian (titulli perandorak: Imp. Caesar Domitius Aurelianus Augustus, 270-275)<sup>43</sup>. Monedha ka diametrin 21 mm dhe peshën 3,97 gr. Në avers është portreti i djathtë i perandorit të veshur me armaturë ushtarake dhe me kurorë në formë

<sup>37</sup> Cagnat 1914: 220; Hafner 2001: 269-270; Veh 2001: 110.

<sup>38</sup> Borić-Brešković 1976: n.1435; Arsenijević 2004; Stamenković, Samardžić 2013: Trebonianus Gallus 174-175 n.20-25.

<sup>39</sup> Stamenković, Samardžić 2013: 176; 179 n. 26.

<sup>40</sup> Ferri 2023: 284.

<sup>41</sup> RIC 1949.

<sup>42</sup> Klawans 1959: 13; Room 1987: 25.

<sup>43</sup> Cagnat 1914: 227-226; Cunliffe 1978: 276; Hafner 2001: 67; Veh 2001: 18-19.

rrezesh ne kokë dhe mbishkrimi: IMP AVRELIANVS AVG, ndërsa në revers është paraqitur figura e hyjit te diellit Sol e kthyer majtas, me dorën e djathtë të ngritur mbi një rob lufte të ulur në tokë dhe me glob në dorën e majtë. Rreth figurës së Solit është mbishkrimi: ORIENS AVG (usti). Në figura janë shenjat XXIR që është shenjë e pastërtisë së metalit (bronz me përqindje të madhe bakri dhe përqindje të vogël argjendi -20:1) e cila është përdorur gjatë shekullit III të erës sonë. Monedha është e prerë mes viteve 273/4. “Oriens augusti” do të thotë “dielli i perandorit duke lidur”, që nënkupton një ditë të re, një fillim të ri dhe pasuri në rritje.



Antoninian prej bronzi i mbështjellur me argjend i kohës së perandorit Aurelianus

Kah fundi i shekullit III<sup>o</sup> kjo monedhe është prodhuar në sasi të mëdha për shkak të inflacionit që e shkaktuan krizat të cilat e kishin përfshirë Perandorinë Romake. Antoninianin e kishte futur në përdorim perandori Karakala (Caracalla) rreth vitit 215 të erës sonë dhe në fillim ishte prej argjendi dhe kishte vlerën e 2 denarëve ndërsa më vonë filloj të punohej nga perzierja e bronzit dhe argjendit (20:1) dhe vlera e kishte rënë në 1,5 denarë dhe shkaktoi inflacion dhe kah fundi i shekullit III<sup>o</sup> punohej vetëm nga bronzi. Në kohën e perandorit Aurelianus në revers të antoninianit shenohej shenja XXI e cila tregonte përzierjen e metalit prej të cilit punohej antoninianet 20:1, pra 5% argjend dhe 95% bronz, ndërsa sigla R është shenjë e punëtorisë monedhëprerëse të Romës.<sup>44</sup>

**11.** Antoninian i reformuar (pas reformave të perandorit Karakala (Caracalla, 198-217)<sup>45</sup> i kohës së perandorit Aurelianus (Imp Caesar Domitius Aurelianus Augustus, 270-275)<sup>46</sup> i punuar prej bronzi me diametër 21 mm

<sup>44</sup> RIC V, 246 270-275.

<sup>45</sup> Veh 2001: 98-100: 57-58; Hafner 2001: 78-79.

<sup>46</sup> Cagnat 1914: 227-226; Cunliffe 1978: 276; Hafner 2001: 67.; Veh 2001: 18-19.

dhe me peshë prej 3,45 gr. Në avers është paraqitja e portretit të djathtë të perandorit me kurorë në formë rrezesh në kokë dhe rreth tij mbishkrimi IMP AVRELIVS AVG, ndërsa në revers është paraqitja e figurave të perandorit nga ana e majtë dhe të hyneshës Concordia në këmbë, duke i shtrënguar dorën njëri tjetrit dhe rreth tyre mbishkrimi: CONCORDIA AVGG (Concordia Augustorum)-harmonia madhështore<sup>47</sup> dhe hyjneshtë e harmonisë perandorake.<sup>48</sup>



Antoninian prej argjendi i kohës së perandorit Aurelianus  
Monedha është prerë mes viteve 272-274 të erës sonë në Romë

**12.** Antoninian prej bronzi i perandorit Diokletianus (IMP CAESAR C (M) AVRELIVS VALERIVS DIOCLETIANVS AVG, 284-305)<sup>49</sup> me dimensione 20 mm dhe me peshë 3,30 gr.



Antoninian prej bronzi i kohës së perandorit Diokletianus

Në avers është paraqitur portreti i djathtë i perandorit me kurorë në formë rrezesh (radiate) dhe rreth portretit mbishkrimi: IMP CC VAL DIOCLETIANVS PF AVG.

<sup>47</sup> RIC 120.

<sup>48</sup> Colonna 2003: 101; Dizionario illustrato 2012: 101; Žepić 2000: 58.

<sup>49</sup> Cagnat 1914: 231-233).

Në revers është paraqitja e Dioklecianit në anën e majtë dhe Jupiterit në anën e djathtë i cili ia jep perandorit fitoren në formë të hyjneshës Victoria mbi glob e rreth këtyre figurave mbishkrimi: CONCORDIA MILITVM që nënkupton harmoninë me ushtri e cila e kishte akklamuar për perandor pas vrasjes së perandorit Numerian. Nën figura është shenja XXI që dëshmon pastërtinë e metalit (bronz me përqindje të madhe bakri dhe një përqindje të vogël argjendi -20:1) e cila është përdorur gjatë shekullit III<sup>o</sup> të erës sonë. Monedha është prerë në vitin 284 në Cyzicus të Greqisë (sot Anadollia në Turqi).<sup>50</sup>

**13.** Follis prej bronzi i perandorit Constantinus I<sup>o</sup> Maximus-Kostandini i Madh (Imp Caesar Flavius Valerius Constantinus Augustus, 306-336)<sup>51</sup> me diametër prej 18 mm dhe me peshë prej 2,87 gr. Monedha i përket tipit të ashtuquajtur “vota coins” (monedhat e betimit). Në avers është paraqitja e portretit të djathtë të perandorit me kurore në kokë e rreth portretit mbishkrimi: CONSTANTINVS AVG (ustus). Në revers është mbishkrimi rrethor: DN CONSTANTINI MAX AVG (Domini Nostri Constantini Maximi Augusti).<sup>52</sup> Te ashtuquajturat “vota coins-vota monedhat” i kishin futur në përdorim perandoret Kostandini i Madh (306-337) dhe Licini (308-324).<sup>53</sup> Brenda kurores së rrumbullakët me motive bimorë mbishkrimi në tri rreshta: VOT XX (votis vicissibus), dhe gjysëmheña.<sup>54</sup> Ky mbishkrim në fakt është frazë e cila pasqyron betimin e perandorit i cili, sipas zakoneve të lashta romake, kërkon sundim 20 vjeçar të suksesshëm duke iu premtuar flijime, sakrificat dhe dhurata përëndive nëse plotësohet kërkesa e tyre.



Follis prej bronzi i kohës së perandorit Constantinus I<sup>o</sup> (Kostandini i Madh)

<sup>50</sup> RIC 263.

<sup>51</sup> Cagnat 1914: 239-242; Hafner 2001: 163-164; Veh 2001: 67-68.

<sup>52</sup> RIC 88a, 157, 159.

<sup>53</sup> Cagnat 1914: 239; Hafner 2001: 163-164; 170.

<sup>54</sup> Sear 1988: 326.

Perandorët i bënin betimet-lutjet (VOTA) duke premtuar që bëjnë fljime e sakrificat të ndryshme nëse perenditë ua plotësojnë dëshirën për sundim sa më të gjatë e më të suksesshëm. Për këtë arsye nëpër monedha hasen betimet për 10 (VOT X), 20 (VOT XX) ose 30 vjet (VOT XXX). Në këtë rast perandori Kosstandini i Madh bën betimin në njëzetëvjetorin e sundimit të tij. Nën kurorë është shenja e punetorisë monedheprerese QT. Monedha është prerë në Ticinum (Itali) rreth vitit 307 si betim-premtim për 20 vjet të sundimit të ardhshëm të suksesshëm të Konstantinit të Madh (ai ishte bërë Augustus në vitin 307, ndërsa Licini në vitin 308 në Konferencën në Carnuntum).

14. Nummus (solidus-pas reformave të perandorit Constantinus I° Maximus (Imp Caesar C (M, L) Flavius Valerius Constantinus Augustus, 306-337),<sup>55</sup> monedhë bizantine prej bronzi (me vlerë të një çerekut të follisit)<sup>56</sup> me diametër 18 mm dhe me peshë 3 gr. Emri i monedhës nummus rrjedh nga gjuha greke dhe do të thotë: monedhë.<sup>57</sup> Monedha i përket të ashtuquajturit “helmeted type (tipi me helmetë)” meqë në avers e ka paraqitjen e portretit të djathtë të perandorit me përkrenare në kokë, rreth të cilit është mbishkrimi: IMP CONSTANTINVS MAX AVG-Imperator Constantinus Maximus Augustus. Kjo monedhë është pjesë e emisioneve të monedhave përkujtimore (commemorative coins) dhe janë emetuar për të përkujtuar ngjarje të veçanta në lidhje me të cilat janë emetuar. Ato kanë dizajnë të veçanta që i referohen rasteve lidhur me të cilat janë emetuar.



Nummus-follis i kohës së perandorit Constantinus I° (Kostandini i Madh)

<sup>55</sup> Cagnat 1914: 239-242; Hafner 2001: 163-164; Veh 2001: 67-68.

<sup>56</sup> Room 1987: 144.

<sup>57</sup> Cagnat 1914: 239-242; Hafner 2001: 90, 163, 164.

Perandori Kostandini i Madh dhe bijtë e tij prej vitit 307 deri 361 të erës sonë kanë emetuar monedha të vogla prej bronzi me qëllim të përkujtimit të kryeqytetit të vjetër-Romës dhe kryeqytetit të ri- Kostandinopojës si simbol të barazisë së dy qyteteve dhe rëndësisë së kryeqytetit të ri të Perandorisë dhe të rëndësisë së re të Konstantinopojës për Perandorinë.<sup>58</sup> Në revers janë paraqitjet e dy figurave: të hyjneshës së fitorës Victoria (hyjneshës së fitores)<sup>59</sup> me flatra e cila qëndron në këmbë, duke mbajtur mburojën e dekoruar me kryq mbi një cippus prej guri, ndërsa në anën e djathtë është figura e vetë perandorit, e rreth këtyre figurave është mbishkrimi VICTORIAE LAETE PRINCEPS PERPETVVS-princi i përjetëshëm, i gëzuar në fitore, ndërsa nën këmbët e figurave janë shkronjat PLN (Londinium, Londër).<sup>60</sup> Në bazë të te dhënave nga mbishkrimet monedha është prerë në vitin 319 të erës sonë në Londër.<sup>61</sup>

**15.** Nummus (solid i reformuar) i perandorit Kostandini i Madh (Imp Caesar Flavius Valerius Constantinus Augustus, 305-337)<sup>62</sup> me dimensione 16-17 mm dhe me peshë 1,8 gr. Në avers është paraqitja e portretit të djathtë të perandorit me kurorë në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: CONSTANTINVS MAX AVG (Constantinus Maximus Augustus). Në revers është paraqitja e dy ushtarëve romakë me heshta dhe me labarum<sup>63</sup> në duar (flamuri me kryq e me monogram te Krishtit me shkronja greke I (Jesus) dhe X (Christos) dhe rreth tyre mbishkrimi GLORIA EXERCITVS<sup>64</sup> i cili lartëson trimërinë dhe fitoret e ushtrisë romake mbi barbarët. Ky tip i paraqitjes së ushtarëve dhe mbishkrimit të tillë në revers është karakteristik për monedhat e perandorëve Constantinus Maximus, Delmatius, Constantinus II<sup>o</sup>, Constans dhe Constantius.

---

<sup>58</sup> Ramskold 2011: 126-128.

<sup>59</sup> Marić 1933: 33,56. Morford, Lenardon 1994: 81, 90, 123-124; Colonna 2003: 448; Dizionario illustrato 2012: 460.

<sup>60</sup> Sear 1988: 327.

<sup>61</sup> RIC VII, 173.

<sup>62</sup> Sear 1988: 326; RIC 22.

<sup>63</sup> Klaić 1980: 778.

<sup>64</sup> Žepić 2000: 112.



Nummus-follis i kohës së perandorit Kostandini i Madh (Constantinus I<sup>o</sup>)

Nën figura të ushtarëve është shkurtesa: SMTS e cila tregon që monedha është prerë në ndonjërin nga punëtoritë monedhëprerëse në Thessaloniki (Selanik).

**16.** Follis përkujtimor prej bronzi i kohës së Kostandinit të Madh i kushtuar qytetit të Romës me dimension 12 mm. Është ruajtur relativisht mirë por i ka dy vrima të shpuara. Në avers është portreti i majtë hyjneshës Roma me përkrenare në kokë dhe rreth portretit mbishkrimi: VRBS ROMA.



Follis përkujtimor prej bronzi i kohës së perandorit Constantinus I<sup>o</sup>  
i kushtuar qytetit të Romës (Urbs Roma)

Perandori Kostandini i Madh gjatë viteve të fundit të sundimit të tij e më vonë edhe bijtë e tij prej vitit 307 deri 361 të erës sonë kanë emetuar monedha të vogla prej bronzi me qëllim të përkujtimit të kryeqytetit të vjetër-Romës dhe kryeqytetit të ri- Kostandinopojës si simbol të barazisë së dy qyteteve dhe rëndësisë së kryeqytetit të ri të Perandorisë dhe të rëndësisë së re të Konstantinopojës për Perandorinë.<sup>65</sup> Monedha është prerë mes viteve 330 dhe 335 të erës sonë.

<sup>65</sup> Ramskold 2011: 126-128.

Në bazë të shenjës SMTS është punuar në punëtoritë monedhëprerëse në Thessalloniki (Selaniku).<sup>66</sup>

Për hirë të vendosjes së selisë perandorake në Kostandinopojë dhe me qëllim të glorifikimit të qendrës së lashtë të Perandorisë-Romës, perandori Kostandini i Madh i i kishte prerë dy seri monedhash komemorative: një të cilën glorifikojë qyteti i Kostandinopojës dhe tjetrën e cila glorifikonte Romën, me portrete të hyjneshave në avers, të cilat i personifikonin këto dy qendra perandorake. Në revers është paraqitja e ujkonjës mitologjike me Romulin e Remin që është simbol i qytetit të Romës. Anash figurës së ulkonjës janë të paraqitura dy yje. Monedha është shpuar me qëllim që të përdoret si stoli dekorative ose si talisman-hajmali për fat ose kundër mësyeshit, syrit të keq. Përpos kësaj monedhe nga Vërbani, më herët janë gjetur edhe 13 monedha të këtilla komemorative me mbishkrim VRBS ROMA.<sup>67</sup>

17. Nummus prej bronzi i kohës së perandorit Constantius Gallus (Flavius Claudius Constantius Nobilissimus Caesar, 351-353)<sup>68</sup> me diameter 23 mm dhe me peshë 4,50 gr.



Nummus-follis prej bronzi i kohës së perandorit Constantius Gallus

Në avers është paraqitja e portretit të djathtë perandorit pa kurorë ose dafinë në kokë, siç zakonisht paraqitej Konstantin Gali dhe rreth tij mbishkrimi: DN CONSTANTIVS NOB CAES (Dominus noster Constantius nobilissimus Caesar). Epiteti Nobilissimus paraqitet tek perandorët romakë e bizantinë bashkë me titullin Caesar, ndërsa për herë të parë këtë epitet e kishte përdorur perandori Geta në vitin 198 të erës sonë. Në revers është paraqitja e skenës ku ushtari në këmbë në anën e djathtë me mburojë e me heshtë në duar. Heshtën

<sup>66</sup> RIC 187.

<sup>67</sup> Čerškov 1962-1963: 317-338.

<sup>68</sup> Cagnat 1914: 244; Lisičar 1971: XXIV, 1, 2.

ia ka drejtuar kalorësit të shtrirë në tokë, i cili e ka zgjatur dorën e majtë drejt sulmuesit duke u mbrojtur ose duke kërkuar mëshirë nga ai. Rreth figurave të dy ushtarëve është mbishkrimi: FEL (icium) TEMP (orum) REPARATIO që do të thote: renovimi, rivendosja apo krhimi i kohëve të lumtura.<sup>69</sup> Sipas cilësive që i ka, monedha është prere rreth vitit 350 të eres sone në punëtorinë monedhëprerëse në Lugdunum (Lion, Francë).

**18.** Follis (me vlerë të denarit të dyfishtë ose 40 nummi, është futur në qarkullim në kohën e reformave të perandorit Diokletianus-Dioklecianit)<sup>70</sup> prej bronzi me diametër prej 14 mm dhe me peshë 1,80 gr. i kohës së perandorit Constantius II° (Imp Caesar Flavius Iulius Constantius Augustus, ishte i biri i dytë i Kostandinit të Madh dhe ka sunduar 324-361).<sup>71</sup> Në avers është paraqitja e portretit të djathtë të perandorit me diademë me perla në kokë dhe rreth saj dhe mbishkrimi: IMP CONSTAN/TIVS PP AVG (Imperator Constantius Pater Patriae Augustus). Monedha i përket “vota coins” meqë në revers është mbishkrimi në 4 rreshta i rrethuar me një kurrore të rrumbullakët prej degëve bimore: VOT / XX / MVL/ XXX, e nën kurorë është shkronja: ...N...Votis/ XX (vicennialibus)/ multus/ XXX (tricennialibus)/ (A)N(T) ose (CO)N(O)B që paraqet betimin për 20 vjet të sundimit dhe lutja përëndive për zgjatjen e mundshme të sundimit deri në tridhjetë vjet të sundimit me premtim të ndonjë shpërblimi përëndive nëse ata e plotësojnë lutjen-dëshirën.



Nummus-follis prej bronzi i kohës së perandorit Constantius Gallus

Perandorët e bënin betimet (VOTA) duke premtuar që bëjnë fljime e sakrificat të ndryshme nëse perënditë ua plotësojnë dëshirën për sundim sa më të gjatë e më të suksesshëm. Për këtë arsye nëpër monedha hasen betimet

<sup>69</sup> Sear 1988: 342; RIC VIII, 94.

<sup>70</sup> Room 1987: 83.

<sup>71</sup> Cagnat 1914: 243-244; Hafner 2001: 90-91; Veh 2001: 26-28.

për 10 (VOT X), 20 (VOT XX) ose 30 vjet (VOT XXX). Kjo monedhë është e prerë ne Antiohi (Antakia), ose ne Konstantinopojë (ne Turqi te sotme) ne vitet 347/348 të erës sonë. Në bazë të shënimeve që i ka kuptohet që monedha është prerë ne Antiohi (Antakia, ose ne Kostandinopojë ne Turqi te sotme) ne vitet 347/348. Në monedhat e ketilla te Konstancit ne revers eshte edhe mbishkrimi CONSTANTIVS AVG, i cili në këtë rast mungon, ndërsa shenja e punëtorisë ku është prerë monedha është e palexueshme.

19. Follis prej bronzi 15 mm, 1,83 gr. i kohës së sundimit të perandorit Valentinianus I° (Imp Caesar Flavius Valentinianus Augustus, 364-375)<sup>72</sup>. Në avers është paraqitja e portretit të djathtë i perandorit me kurorë ne kokë dhe rreth portretit mbishkrimi DN VALENTINIANVS PIVS FELIX AVG (Dominus Noster Valentinianus Pius Felix Augustus). Follis është monedhë prej bronzi të cilën e kishte futur në përdorim perandori Diokleciani (Diocletianus, 284-305),<sup>73</sup> por pasardhesit e Kostandinit e kanë reduktuar peshen, madhesine dhe vleren e tij. Në gjuhën angleze quhet “reduced follis”-follis i reduktuar, i zvogëluar.<sup>74</sup> Në revers figura e perandorit duke qëndruar ne kembë me glob ne doren e majtë mbi te cilin eshte hyjnesha e fitores Victoria, ndërkaq ne doren e djathte mbane skeptrin-simbolin perandorak. Rreth figures mbishkrimi: RESTITVTOR REI P (Restitutor Rei Publicae-rindertues i republikes. respektivisht rivendosës i sistemit republikan).



Follis prej bronzi i kohës së perandorit Valentinianus I°

Nën këmbët e perandorit është vendosur shenja e punëtorisë monedhëprerëse THS që do të thotë që monedha është prerë mes viteve 364-367 në punëtorinë e Selanikut (Thessaloniki ne Greqi).<sup>75</sup>

<sup>72</sup> Cagnat 1914: 245, 247; Veh 2001: 114-115.

<sup>73</sup> Cagnat 1914. 231-233; Hafner 2001: 103-104.

<sup>74</sup> Room 1987: 83.

<sup>75</sup> RIC IX, 6a, 8.

**20.** Nummus prej bronzi i perandorit Valentinianus I° (364-375) me madhësi prej 17 mm.



Nummus-follis prej bronzi i kohës së perandorit Valentinianus I°

Në avers është portreti i djathtë i perandorit me diademë në kokë e rreth tij mbishkrimi: DN VALENTINIANVS PF AVG (Dominus Noster Valentinianus Pius Felix Augustus). Në revers është figura e hyjneshës Victoria duke ecur e kthyer majtas me kurore dhe me palmë në dorë e rreth saj mbishkrimi: SECVRITAS REIPVBLICAE - (siguria e shtetit). Kjo monedhë është prerë mes viteve 367-375.<sup>76</sup> Nën figuren e hyjneshes është shenja e palexueshme e punëtorisë monedheprerëse ku është punuar monedha (ndoshta Siscia).

**21.** Nummus prej bronzi i perandorit Valens (364-378, Imp Caesar Flavius Valens Augustus, bashkësundimtar i vëllait të vet Valentinianus I°, i cili ishte perandor i pjesës lindore të Perandorisë, 364-378)<sup>77</sup> me diametër prej 17 mm dhe peshë prej 3gr. Në avers paraqitja e portretit të djathtë të perandorit në diademë me perla dhe rreth tij mbishkrimi: DN VALENS PF AVG (Dominus Noster Valens Pius Felix Augustus), dësora nën figure shenja e punëtorisë monedheprerëse: TES (Thessaloniki).<sup>78</sup>

<sup>76</sup> RIC IX-15 a, b.

<sup>77</sup> Cagnat 1914: 246; Lisičar 1971: XXIV, 1, 2.

<sup>78</sup> Sear 1988: 347.



Nummus-follis prej bronzi i kohës së perandorit Valens

Në revers është paraqitja e portretit të djathtë të perandorit me pajisje luftarake në këmbë i cili me dorë të djathtë tërheq zvarrë një rob lufte ndërsa në të majtën mbanë labarum (flamurin me kryq e me monogram të Krishtit)<sup>79</sup> dhe rreth saj mbishkrimi: GLORIA ROMANORVM (Lavdia e romakëve kundër barbarëve).<sup>80</sup>

**22.** Follis prej bronzi me dimension 32 mm i periudhës së perandorit Justinianus I° (Fl. Iustinianus, 527-565).<sup>81</sup> Në avers është portreti i djathtë i perandorit Justinian me kurorë në kokë dhe rreth tij mbishkrimi: DN IVSTINIANVS PP AVG. Në revers është shkronja e madhe M, mes saj një kryq e anash dy yje. Follisi ishte lloj i monedhës metalike në systemin monetar romak e bizantin i cili ka pësuar mjaft ndryshime gjatë histories së vet.



Follis prej bronzi i kohës së perandorit Justinianus I°

Ky lloj i monedhës është përdorur prej vitit 498 si monedhë e madhe metalike bizantine me vlerë prej 40 nummi. Shkronja e madhe M (M=40

<sup>79</sup> Klaić 1980: 778.

<sup>80</sup> RIC IX, 16a.

<sup>81</sup> Cagnat 1014: 250.

greqisht) në reversë të monedhave bizantine tregon vlerën nominale 40 nummi të njohur si follis. Monedhat bizantine fillojnë me reformat e perandorit Anastasios ose Anastasius (431-518) në vitin 498 i cili e kishte reformuar sistemin monetar pjesë e të cilit ishin solidus prej ari dhe nummus prej bronzi.<sup>82</sup>

## Përfundime

Në lokalitetin Vërbani të Kllokotit gjatë vitit 2023 e 2024 si zbulime rasti është gjetur një numër i konsiderueshëm monedhash, të cilat i përkasin periudhës të sundimit romak në Kosovë prej shekullit II<sup>o</sup> deri në gjysmën e dytë të shekullit IV<sup>o</sup> të erës sonë respektivisht kohës së perandorshave Faustina Maior (bashkëshortja e perandorit Antoninus Pius, 138-140) e Sallustia Orbiana (bashkëshortja e perandorit Severus Alexander, 225-227) dhe të perandorëve: Septimius Severus (193-211), Geta (209-211), Gordianus III<sup>o</sup> (238-238-244), Philippus I<sup>o</sup> (244-249), Trebonianus Gallus (251-253), Volusianus (251-253), Gallienus (253-268), Aurelianus (270-275), Diocletianus (284-305), Constantinus I<sup>o</sup> (306-337), Constantius Gallus (326-354), Constantius II<sup>o</sup> (337-361), Valentinianus I<sup>o</sup> (364-375), Valens (364-378) dhe të perandorit Justinianus I<sup>o</sup> (527-565).

Në aversë të këtyre monedhave janë paraqitur e portreteve të perandorëve, ndërsa në reversë paraqiten figurat e perandorëve por edhe të hyjnive: Sol (hyj i Diellit), Annona (hyjneshë e lidhur me hyjneshën Ceres, dhe personifikim hyjnor i shpërndarjes së drithit popullit romak), Ceres (Cerera, hyjneshë kjo e bujqësisë dhe e pjellorisë), Securitas (hyjneshë e sigurisë së shtetit), Concordia (hyjneshë e harmonisë), Roma (hyjneshë e cila e personifikonte qytetin e Romës) e Victoria (hyjneshë me flatra e fitores, më së shpeshti e paraqitur në reverse të monedhave romake e bizantine bashkë me figurat e perandorëve), paraqitet e kafshëve të ndryshme ose shkronjat e mëdha që tregojnë vlerën nominale të monedhës si në rastin e follisit të kohës së perandorit Justiniani I<sup>o</sup>. Monedhat janë të punuara prej argjendi e prej bronzi dhe i përkasin llojeve të ndryshme. Në mesin e tyre ka monedha të llojit: denarius, sestertius, antoninianus, antoninianus të reformuar me rastin e reformave të perandorit Caracalla, pastaj monedha të llojit nummus, follis, follis i reduktuar, solidus dhe solidus i reformuar me rastin e reformave të

<sup>82</sup> Sear 1987.

perandorit Constantinus Maximus (Kostandini i Madh), imitime prej bronzi të monedhave prej argjendi si dhe monedhat komemorative dhe monedha e ashtuquajtur limes denarius. Në bazë të të dhënave nga mbishkrimet në këto monedha kuptohet se ato ishin prerë në punëtori monedhëprerëse në Viminacium (Mezi e Epërme, Kostollac, Serbi e sotme), Siscia (Panoni-Sisak, Kroaci e sotme), Romë (Itali), Ticinum (Pavia, Itali), Lugdunum (Lion, Francë), Antaki, Kostandinopojë (Turqi), Selanik (Greqi). Pos monedhave të trajtuara, kohëve të fundit në Vërban është gjetur edhe një numër i monedhave të dëmtuara dhe të shlyera për shkak të acideve që i përmban dheu në këtë lokalitet e që, sipas banorëve lokalë, janë pasojë e plehërimit të tokës me pleh nga stallat e derrave, i cili përmban koncentrim të madh të acideve. Këto monedha janë tejet të dëmtuara saqë nuk dallohen figurat e as nuk mund të lexohen mbishkrimet e shënuara mbi ato. Bazuar në të dhënat e mbishkrimeve të këtyre monedhave, shihet se ato janë prerë në punëtorit monedhëprerëse të Viminacium (Moesia Superiore), Romës (Itali), Ticinum (Pavia, Itali), Antiochia (Antakia, Turqi), Constantinopolis (Stamboll, Turqi), Thessalonica (Selanik, Greqi). Monedhat në fjalë paraqesin dokumente të rëndësishme për studimin e së kaluarës antike të Kosovës, veçanërisht pasi disa lloje të monedhave të gjetura së fundmi nuk janë dëshmuar deri më tash në këtë rajon<sup>83</sup>.

---

<sup>83</sup> *Kontribute të tjera: Fotot e monedhave:* Prof. dr. Naser Ferri. *Përpunimi teknik dhe dizajni i fotove:* Lis Myftari, Spreht.

**Bibliografi:**

- ARSENIJEVIĆ 2004, Arsenijević M., Periodi pohranjivanja ostava rimskog novca tokom III veka u Gornjoj Meziji, Glasnik Srpskog Arheološkog Društva 20, Beograd 2004: 225-234.
- BAKOS 1994, Bakos M., Sylloge nummorum graecorum, Hungary, Magyar Nemzeti Muzeum, vol. II, Budapest 1994.
- BORIĆ-BREŠKOVIĆ 1976, Borić-Brešković B., Novac kolonije Viminacium, Beograd 1976.
- BORIĆ-BREŠKOVIĆ 1979, Borić-Brešković B., Jedan manji nalaz rimskog novca iz Popovca, Zbornik Narodnog Muzeja, IX.X, Beograd 1979: 39-54.
- CAGNAT 1914, Cagnat R., Cours d'épigraphie latine, Paris 1914.
- CALABI LIMENTANI 1985, Calabi Limentani I., Epigrafia latina, Milano 1985.
- COHEN 1930, Cohen H., Description historique des monnaies frappées sous l'Empire Romain. Deuxième édition. Réimpression conforme à l'édition Rollin et Feuermann Paris 1880-1892, Published by Leipzig: Buchhandlung Gustav Fock GMBH 1930.
- COLONNA 2003, Colonna B., Dizionario mitologico, Divinita, eroine ed eroi, re e regine, satiri e ninfe, muse, giganti, mostri, oracoli e Sibille.... Rusconi Libri, Roma 2003.
- CUNLIFFE 1978, Cunliffe B., Rome and her Empire, A McGraw-Hill co-publication, New York 1978.
- ČERŠKOV 1962-1963, Čerškov E., Kasnoantičkie ostava iz Dobrotina na Kosovu, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije-Buletin i Muzeut të Kosovës, VII-VIII, Prishtinë 1962-1963: 317-338.
- ČERŠKOV 1979, Čerškov E., Rimljani na Kosovu i Metohiji, Arheološko Društvo Jugoslavije, Beograd 1969.
- DIZIONARIO ILLUSTRATO 2012, Dizionario illustrato di mitologia Greca e Romana, Varese 2012.
- FERRI 2001, Ferri N., Monumentet ushtarake të ushtrisë romake, Dukagjini, Pejë 2001.
- FERRI 2008a, Ferri N., Një monedhë interesante romake e gjetur në Dobrushë të Istogut, Zëri Prishtinë, 26.04.2008: 31.
- FERRI 2019, Ferri N., Peja gjatë antikitetit-Peja during Antiquity, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2019.
- FERRI 2021, Ferri N., Monedhat romake me simbole ushtarake të gjetura në

- rajonin e Pejës, Gjurmime Albanologjike, Seria e Shkencave Historike, n.51, IAP, Prishtinë 2021: 41-60.
- FERRI 2023, Ferri N., *Novitates epigraphicae et numismaticae quae inter anos MCMLXXX et MMXX in Kosovo repertae et editae sunt* -Gjetjet e reja epigrafike e numizmatike të zbuluara dhe të publikuara në Kosovë mes viteve 1980 dhe 2020- Instituti Albanologjik, Prishtinë 2022.
- HAFNER 2001, Hafner G., *Bildlexikon antiker personen*, Albatros Verlag, Düsseldorf 2001.
- KLAJČIĆ 1980, Klaić B., *Rječnik stranih riječi*, Nakladni Zavod Matice hrvatske, Zagreb 1980.
- KLAWANS 1959- Klawans Z.H., *Reading and dating Roman Imperial Coins*, Second Edition, Whitman Publishing Company, Racine, Wisconsin 1959.
- LISIČAR 1971- Lisičar P., *Grci i Rimljani*, Školska Knjiga, Zagreb 1971.
- MARIĆ 1933, Marić R., *Antički kultovi u našoj zemlji*, Beograd 1933.
- MATIJAŠIĆ 2002, Matijašić R., *Uvod u latinsku epigrafiju*, Filozofski fakultet u Puli, Knjižnica Tabula, sv.3, Pula 2002.
- MORFORD, LENARDON 1994, Morford M.&Lenardon R.J., *Classical Mythology*, Longman Publishers USA 1994.
- PICK 1898, Pick B., *Die Antiken Münzen Nord Griechenlands I -1 Dacien und Moesien – erster Halbband*. Berlin, 1898.
- RAMSKOLD 2001, Ramskold L., *Coins and medallions struck for the inauguration of Constantinopolis 11 May 330*, Niš & Byzantium IX, Niš 2011: 125-158.
- RIC III, *Roman Imperial Coinage*, vol. III, Antoninus Pius to Commodus. By H. M.A. Mattingly and E.A. Sydenham, Spink&Son Ltd., London 1930.
- RIC IV, *Roman Imperial Coins*, British Catalogue of Roman Imperial currency from the time of the Battle of Actium (31 BC) to Late Antiquity in 491 AD, vol. 4 c, Gordian III°-Uranus Antoninus (238-253), by H.M.A. Mattingly, E.A.Sydenham, C.H.V. Sutherland London 1986.
- RIC V, I, H.M.A. Mattingly&E.A. Sydenham&P. Web, *Roman Imperial Coinage*, British Catalogue of Roman Imperial currency from the time of the Battle of Actium (31BC) to Late Antiquity in 491 AD, vol. V,I: Valerian-Florian (253-276), by Percy H. Webb, London 1927.
- RIC VII, Brun P., *The Roman Imperial Coinage*, vol. VII: Constantine and Licinius AD 313-337, London 1966.
- RIC IX, Pierce J., *The Roman Imperial Coinage*, Vol. IX, Valentinian I-Theodosius I, London 1933.
- ROOM 1987, Room A., *Short loan Dictionary of coins names*, Routledge&Kegan

- Paul, and New York 1987.
- SCHMIDT 2004, Schmidt J., Roman mythology, Grange Books, Rochester 2004.
- SEAR 1988, Sear D.R., Roman coins and their values, Fourth Revised Edition, B.A. Seaby Ltd. London 1988.
- SPAETH 1996, Spaeth B.S., The Roman goddess Ceres. University of Texas Press 1996.
- SPASIĆ-ĐURIĆ, Spasić-Đurić D., Viminacijum: glavni grad rimske provincije Gornje Mezije, Narodni Muzej Pozarevac 2002.
- SREJOVIĆ, CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ 1979, Srejskić D., Cermanović-Kuzmanović A., Rečnik grčke i rimske mitologije, Beograd 1979.
- SREJOVIĆ, CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ 1996, Srejskić D., Cermanović-Kuzmanović A., Leksikon Religija i mitova drevne Evrope, Drugo dopunjeno izdanje, Savremena Administracija Beograd 1996.
- STAMENKOVIĆ, SAMARDŽIĆ 2013, Stamenković, S. Z., Samardžić, G. M., Ostava rimskog novca iz sredine III vijeka sa lokaliteta Izvore kod Kosovske Mitrovice, Zbornik radova Filozofskog fakulteta u Prištini XLIII (2), Mitrovica 2013: 163-181.
- SUAREZ 2005- Suarez R., ERIC, The Encyclopedis of Roman Imperial Coins, Dirty Old Coins, First Edition 2005.
- VARBANOV 2005, Varbanov I., Greek Imperial Coins and their values, Vol.I : Dacia, Moesia Superior, Moesia Inferior, Bourgas 2005.
- VEH 2001, Veh O., Leksikon rimskih careva od Augusta do Justinijana I, 27. g. pr. Kr.- 585. g., Naklada Slap, Jastrebarsko 2001.
- VOJVODA,REDŽIĆ 2018, Vojvoda M.,Redžić S., Cirkulacija rimskog novca u srpskom delu limesa (I-V vek), Rimski limes i gradovi na tlu Srbije-Roman Limes and cities on the territory of Serbia, Galerija Srpske Akademije Nauka i umetnosti/Gallery of the Serbian Academy Sciences and Arts 145, Srpska Akademija Nauka i Umetnosti-Arheološki institut, Beograd 2018: 50-55.
- ŽEPIĆ 1993, Žepić M., Hrvatsko-latinski rječnik, Croatian-latin Dictionary, Reprint, Zagreb 1993.
- ŽEPIĆ 2000, Žepić M., Latinsko-hrvatski rječnik, Lexicon latino-croaticum, Školska knjiga, Zagreb 2000.

**Naser FERRI**

Albanological Institute of Pristina

Email: [naserferri@yahoo.com](mailto:naserferri@yahoo.com)ORCID: <https://orcid.org/0009-0008-4112-871X>

KUD: 930.1(496.51)(05)

**SUMMARY**  
**SOME NEW FINDINGS OF ROMAN COINS**  
**IN VĚRBAN OF KLLOKOT**

Archaeological discoveries at the VĚrban locality of Kllokot during 2023 and 2024 have yielded a substantial number of coins dating to the period of Roman rule in Kosovo, spanning from the second century to the late fourth century AD, with an additional early Byzantine specimen extending into the sixth century. These finds correspond to the reigns of Empresses Faustina Maior, wife of Antoninus Pius, and Sallustia Orbiana, wife of Severus Alexander, as well as a broad succession of Roman emperors, from Septimius Severus and Geta through the Tetrarchic and Constantinian periods, and culminating with Justinian I. The chronological breadth of this assemblage attests to prolonged monetary circulation and sustained administrative continuity at the site.

The iconographic analysis of the coins reveals a consistent pattern characteristic of Roman and early Byzantine monetary production. Obverse sides predominantly feature imperial portraits, serving as visual affirmations of political authority and legitimacy. Reverse sides display a rich repertoire of imagery, including representations of emperors and deities such as Sol, Annona, Ceres, Securitas, Concordia, Roma, and Victoria, as well as animal motifs and, in some cases, large letters indicating nominal value, notably on the follis of Justinian I. These images reflect key ideological themes of imperial propaganda, including prosperity, security, harmony, and military success. From a typological perspective, the coins are struck in silver and bronze and encompass a wide range of monetary denominations and reforms. The assemblage includes denarii, sestertii, antoniniani and reformed antoniniani introduced under Caracalla, as well as nummi, follises, reduced follises, solidi, and reformed solidi associated with the monetary reforms

of Constantine the Great. The presence of bronze imitations of silver coins, commemorative issues, and so-called *limes* denarii further illustrates the complexity of monetary circulation and local adaptation within the imperial economy. Mint attribution based on inscriptions and exergue marks indicates that the coins were produced in both central and provincial mints, including Viminacium (Moesia Superior), Siscia, Rome, Ticinum, Lugdunum, Antioch, Constantinople, and Thessaloniki. This wide geographic distribution underscores the integration of Vërban into extensive imperial economic and administrative networks linking the central Balkans with other regions of the Roman world.

In addition to the well-preserved specimens analyzed in this study, numerous heavily damaged and corroded coins have recently been identified at the site. According to local accounts, the deterioration is likely related to soil acidity, possibly intensified by agricultural practices involving manure fertilization. The severe corrosion of these coins has rendered their iconography and inscriptions largely illegible, limiting their analytical value but nevertheless attesting to the density of monetary material present at the site. In conclusion, the numismatic evidence from Vërban represents a significant documentary source for the study of Kosovo's ancient past. Several of the coin types identified have not previously been attested in this region, thereby expanding the existing corpus and contributing new data to regional historiography. These finds enhance our understanding of chronological development, imperial presence, and monetary circulation, confirming the importance of Vërban as a key site within the Roman and early Byzantine landscape of Kosovo.